



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo

KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

Anëtarit të Komitetit për Politikë dhe Financa
Z/znj _____

Në bazë të dispozitave të nenit 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale si dhe në bazë të dispozitave të nenit 41 të Statutit të Komunës së Novobërdës.

F T O J

Mbledhjen e dymbëdhjetë të Komitetit për Politikë dhe Financa e cila do të mbahet më 16.12.2019 (e hënë) duke filluar në ora 10:00.

Rendi i ditës

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-se;
2. Shqyrtimi i Raportit Financiar për tremujorin e tretë Korrik-Shtator 2019;
3. Të ndryshme.

Mbledhja do të mbahet në hapësirat e K.K-së në Novobërdë.

Më:09.12.2019
Në: Novobërdë



Kryesues i Kuvendit
Nebojsa Arsic

Nebojsa Arsic

01-667
09.12.2019



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo–Municipality of Novo Brdo

KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e njëmbëdhjetë e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur më 18.11.2019, duke filluar në orën 10:00. Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesusi i Kuvendit Nebojsa Arsic, Anëtarët e KPF-së: Mirjana Simijonovic, Milica Jovanovic, Xhejlane Behluli, Selatin Nuhiu, Drejtori i Administratës Driton Abdyli, Shefja e ZKKK Jasmina Denic dhe ZKKK Sami Vllasaliu.

Kryesuesi pasi përshëndeti të pranishmit tha: Para se të fillojmë me rendin e ditës duhet konstatuar kuorumin prezentë janë të gjithë antarët e KPF-së pas kësaj e hapi mbledhjen me këtë:

R e n d d i t e

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-se;
2. Propozim plani Aksional për të riatdhësuarit;
3. Propozim plani Aksional për Kthim të qëndrueshëm;
4. Të ndryshme.

Kryesusi tha: a keni ndonjë propozim apo pajtoheni me këtë rend dite?

Drejtori i Administratës Driton Abdyli pasi përshëndeti të pranishmit tha: kërkoj nga KPF-ja që për mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të futet pika për pruarjen e vendimit për shitjen e automjeteve të paperdorura në bazë të raportit nga komisioni i formuar nga Drejtori i Administratës për vlerësimin e gjendjes së Automjeteve të Komunës, kjo pikë ka qenë edhe me herët dhe është terhequr nga Kuvendi, ju faleminderit.

Selatin Nuhiu pasi përshëndeti të pranishmit tha: unë e kam një pyetje për Drejtorin para se me fut këtë pikë, a ka ndryshu materiali apo është materiali i njëjtë.

Driton Abdyli tha: jo nuk ka ndryshuar asgjë, kjo pikë është terhequr nga Kuvendi dhe vetëm kam ardh me ju njoftu por kjo pikë ka qenë njëher në KPF dhe unë kam të drejt ta propozoj direkt në Kuvend por Kryesusi më tha me ardhë edhe në KPF edhe pse kjo pikë ka kaluar njëher në KPF.

Selatin Nuhiu tha: unë jam për mos më kalu kjo pikë, nese ishem shku sipas procedurave Drejtori sot është duhur të sjell material tjetër, duhet të jeni më serioz në raport me Kuvendin dhe KPF-ën.

Driton Abdyli tha: nuk ka se çka të ndryshohet tjetër në material, perseri me dal komisioni perseri e bënë të njëjtin vlerësim, kjo pikë pasi ka kaluar njëher në KPF tash duhet të shkoj drejt në Kuvend pasi që Kuvendi ka kërkuar shtyerjen për një mbledhje të ardhshme dhe ne kemi vendosur që për këtë mbledhje ta propozojm këtë pikë.

Selatin Nuhiu tha: duke filluar prej Kryetarit të Komunës si dhe Drejtorat këta nuk janë serioz me ne, vetëm pikat që po duhet të vin tëk ne po kalojnë, është raporti financiar tremujore në muajin e kaluar është duhur të vij por perseri nuk ka ardhur.

Driton Abdyli tha: je duke i lidh qështjet keq, raporti financiar nuk është punë e imja, unë kam qenë çdo herë në mbledhje të Kuvendit edhe kur kam pasur pika edhe kur nuk kam pasur.

Kryesuesi tha: kush është që propozimi i Drejtorit të Administratës të shkoj në Kuvend?

Aprovohen me 4 vota për dhe 1 kunder (Selatin Nuhii) nga antarët e KPF-së ky propozim që të shkoj në Kuvend.

Pika e parë: Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-se;

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Pasi nuk pati vërejtje procesverbali aprovohet njëzëri nga antarët e KPF-së.

Pika e dytë: Propozim plani Aksional për të riatdhesuarit;

Kryesusi për këtë pikë ja dha fjalën ZKKK Sami Vllasaliut.

Samii Vllasaliu pasi pershendeti të pranishmit tha: bëhet fjalë për planin aksional për riatdhesim, pra në muajin tetor nga Kryetari i Komunës është nxjerr një vendim dhe është formuar një komision dhe kordinator i këtij grupi kam qenë unë dhe në bashkpunim me Ministrin e Punëve të Brendshme departamenti për personat e riatdhesuar dhe me përkrahje të organizates së gëzë gjerman kemi pasur rastin që të gjitha Komunitetë e Kosovës ta hartojmë një plan të tillë. Sa për njoftim nuk kemi të bëjmë me një plan që është hartuar prej zëros por është një plan që është nxjerr prej strategjisë për personat e riatdhesuar dhe në të gjitha Komunitetë e Kosovës plani është 90% i njëjtë vetëm se karakteristikat ndryshojnë, mirëpo ajo që është më e rëndësishmja aprovimi i këtij plani ka të bëjmë me planin nacional për zbatimin e marrëveshjes së stabilizimit asociativ apo MSA-së ku Qeveria e Kosovës ka marrë përsipër që gjatë muajit nëntor të aprovohen të gjitha planet në të gjitha Komunitetë, pothuajse një pjesë e madhe e Komuniteteve i kanë aprovuar, unë jam i gatshëm nëse kemi ndonjë pyetje apo vërejtje por perseri e theksoj se është vetëm një plan e nuk është strategji. Sigurisht e din se në Komunitetin tonë janë afër 90 persona të riatdhesuar dhe ne si zyrtarë për kthim jemi pika kryesore e këtyre personave por tash së fundmi një rol kryesor e ka edhe zyrja e punësimit, ju faleminderit.

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Pasi nuk pati diskutime aprovohet njëzëri kjo pikë që të shkoj në Kuvend.

Pika e tretë: Propozim plani Aksional për Kthim të qëndrueshëm;

Kryesusi për këtë pikë ja dha fjalën Shefes së ZKKK Jasminë Denic.

Jasmina Denic pasi pershendeti të pranishmit tha: kerkoj falje që materialin nuk e kemi marrë në të dy gjuhët por e dini si ka ndodhur rasti, besoj që për Kuvend do ta kemi edhe në gjuhën shqipe. Është obligim i yni që në bazë të urdhërësës që na ka dërguar Ministria e Komuniteteve dhe Kthimit, në bazë të nenit 7 të njëjtës urdhëresë ta pregadisim këtë planin aksional për kthim dhe në muajin gusht ja kam parashtruar Kryetarit një kërkesë që ta formoj një komision që do të punoj në këtë plan, dhe në bazë të vendimit kryetarë e komisionit kam qenë unë, antarë kanë qenë Drejtori i Katastrit dhe zyrtari i Arsimit, ky plan aksional ka qenë model i përbashkët i të gjitha Komuniteteve ndoshta një dallim prej 20% siç e përmendi edhe kolega që ti fusim disa karakteristika që janë për Komunitetin tonë, kështu që ne e kemi pregadit këtë planin aksional në kuader të statutit të Kosovës dhe rregulloren për mbrojtjen dhe të drejtat e të kthyerve. Qëllimi ynë është kthimi i qëndrueshëm për të kthyerit në vendin tonë, pastaj ata që janë shpengulur në Serbi, Maqedoni dhe Mal të Zi. Ky plan aksional na ndihmon që të gjejmë dhe kerkojmë më tutje donatorë për realizimin e kthimit, me një buxhet të vogël kemi arritur që të realizojmë plane të mëdha, nëse ka ndonjë pyetje do të mundohem tju përgjigjem, ju faleminderit.

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Pasi nuk pati diskutime aprovohet njëzëri kjo pikë që të shkoj në Kuvend.

Pika e katërt: Të ndryshme.


Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Milica Jovanovic pasi pershendeti tha: e kam një propozim, duke pasur parasysh se po afrohen festat e fundvitit kishte qenë mirë të pregadisim ndonjë kalendar, fletore, shkrpse, laps për antarët e Kuvendit, si dhe pasi që kemi pasur vdekjen e kolegut Afrimit i cili na ka shërbyer për sa vite në Kuvend kishte qenë mirë tja pregadisim ndonjë falenderim familjes së tij për punën që e ka bërë në Kuvend, ju faleminderit.

Pasi nuk pati diskutime Kryesuesi i falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në orën 10:40.

Procesëmbajtëse
Valmire Mustafa


Procesverbali i KPF-së



Kryesues i Kuvendit

Nebojsa Arsic

